



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 8 të Rregullores Nr. 01/2017 për Marrëdhënie Pune, dispozitave të Rregullores Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, si dhe në bazë të nenit 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM
për plotësimin e vendeve të punës

I. Pozita: Udhëheqës i Departamentit Ligjor për Auditim

Referenca:	UDLA/ZKA/16-08/17
Grada:	ZKA/03
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja:	Me mandat tre (3) vjeçar
I përgjigjet:	Ndihmës Auditorit të Përgjithshëm
Vendi:	Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Udhëheqësi i Departamentit Ligjor për Auditim është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të Departamentit në përputhje legjislacionin në fuqi, me Planin e Vjetor të Auditimit dhe aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Udhëheqësi i Departamentit Ligjor për Auditim është përgjegjës për:

1. Dhënien e këshillave profesionale dhe opinioneve ligjore për zbatimin e legjislacionit në fuqi;
2. Propozimin, hartimin dhe zbatimin e dokumenteve, akteve nënligjore dhe strategjive nga fushëveprimtaria e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
3. Analizimin dhe vlerësimin juridik të akteve para vendimit përfundimtar të Auditorit të Përgjithshëm;
4. Përcjelljen e ndryshimeve dhe plotësimeve të reja ligjore, informon punojësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe u vë në dispozicion këto akte;
5. Siguron rishikimin e cilësisë për çështjet e auditimit dhe bënë kualifikimin juridik të gjetjeve në auditimin e rregullsisë dhe performancës;
6. Rishikimin e pajtueshmërisë ligjore duke përfshirë kontrollin dhe sigurimin e cilësisë në aspektin ligjor të memorandumeve dhe raporteve të auditimit;
7. Pjesëmarrjen dhe kontributin, sipas kërkesave, në diskutimet që i zhvillojnë departamentet e auditimit me entitetet e audituara para hartimit të raportit final të auditimit;

8. Pjesëmarrjen, sipas nevojës, në takimet punuese dhe dëgjimet publike në Komisionet Parlamentare, për diskutimin e çështjeve që ndërlidhen me mandatin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo shqyrtimin e projektligjeve që janë në procedurë parlamentare;
9. Kryerjen e analizave të rasteve indikative për shkelje të detyrave, dhënien e opinionëve dhe bashkëpunon me organet e ndjekjes dhe me institucionet tjera lidhur me çështjet e caktuara;
10. Përfaqësimin e ZKA-së, sipas autorizimit të Auditorit të Përgjithshëm, në procedurat administrative, gjyqësore dhe të arbitrazhit, duke i përcjellë ato në të gjitha nivelet në pajtim me legjislacionin në fuqi;
11. Bashkëpunon me udhëheqësit e departamenteve të auditimit, duke analizuar dhe vlerësuar proceset e punës brenda Divizionit dhe i propozon Ndhmës Auditorit të Përgjithshëm ndryshimet dhe përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;

Kërkesat themelore:

1. Diplomë në fakultetin juridik;
2. Gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale; dhe
3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.

Kompetencat/shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Procedura e Konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë punonjësit brenda saj.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 01/2017 për Marrëdhënien e Punës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2017 për Organizim të brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës në ZKA.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faja e internetit e ZKA-së në adresën <http://www.zka-rks.org/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Musine Kokalari nr. 87 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Formularët mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1005.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në tabelën e shpalljeve.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda katër (4) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.